



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	18.12.2023	27.12.2023	2023/1011

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.12.2023, GOE “VIA EGNATIA SH.P.K.; NNSh VAAKAL; Natyra”.- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1011, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE “EING COM SH.P.K. EL BAU SHPK”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirembajtja verore dhe dimërore e rrugeve” me nr. të prokurimit: "615-23-4993-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë publike kornizë, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **650,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Konsiderojmë se janë shkelur dispozitat ligjore si në vijim:

AK ka shkelur nenin **1 dhe 6 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;

AK ka shkelur nenin **7 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;

AK ka shkelur nenin **11 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;

AK ka shkëlur nenin **56 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;

AK ka shkëlur nenin **59 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe **40 të RRPP-001/2022**.

AK ka shkëlur nenin **60 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;

AK ka shkëlur nenin **61 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, **41 i RRPP-001/2022** dhe **11 i UPP- 001/2023**

AK ka shkëlur nenin **69 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;

AK ka shkëlur nenin **72 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, **38 i RRPP-001/2022** dhe **10 i UPP-001/2023**

1. AK ka shkëlur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejtë ka shpërblyer me kontratë Grupin e OE EING COM SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K. të cilët e posedojnë çmimin më të lartë se tenderi jonë për 237,223.83€ përkatësisht për 71.82%. Bazuar në nenet e cekura më lartë si dhe bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022, AK është e obliguar të luaj rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe ekonomike përkatësisht duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Po që se shikohet me kujdes oferta e GOE të shpallur fitues, më saktësisht pozicioni 1 i tabelës B vetëm të paraqitur në vazhdim, i bie se për pastrimin e 2496315.94m² (apo afërsisht 700 km rrugë) për 24 orë, GEO fitues do të paguhet 6,240.79€. Sipas klimës që mbretëron në Komunën e Podujevës, shpesh ndodh që të kemi deri 60 ditë në vit që duhet me intervenua në pastrimin e rrugëve, atëherë për një vit i bie të paguhet 374,447.40€(60ditë x 6,240.79€). Nëse kjo shumëzohet me dy vite atëherë del që vetëm me këtë pozicion ky GOE do të i kushtoj AK-së 748,894.80€. Sipas kësaj po i bie se AK do të mbetet pa buxhet akoma pa e kryer dimrin e parë e që është indikacion i qartë për keqpërdorim të madh të buxhetit të parashikuar. Shihe tabelën:

B: Mirëmbajtja dimërore:

Pastrimi i borës, akullit, kryposja dhe pastrime tjera, në këtë sezonë.

		Njësia	Sasia	Çmimi /24h	Totali
I	Punët e shërbimeve				
1	Largimi i borës dhe akullit në rrugët e fshatrave	m ²	2,496,315.94	0.0025	6,240.79
TOTALI					6,240.79

Pra kjo tregon hapur që ky çmim është jashtëzakonisht çmim më i lartë se çmimi i tregut e ku ngjashëm me këtë, ky GEO i ka pothuajse edhe të gjitha çmimet tjera në tenderin e tij. Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe marrë për bazë çmimet e vitit të kaluar, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke mos administruar procedurën sipas neneve të cekura më lartë. Kjo tregon hapur se gjatë ri-vlerësimit të tenderëve AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022.2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së me rastin e rivlerësimit pasi që nuk i ka trajtuar aspak si të barabartë tenderuesit pjesëmarrës. Është e vlefshme të ceket ky paradoks ku komisioni i vlerësimit neve na e ka verifikuar komplet makinerinë që e kemi paraqitur në tender dhe atë të noterizuar sipas procedurës en-minutes edhe pse verifikimi i tillë nuk ishte përcaktuar si mundësi në dosjen e tenderit duke na e kontestuar edhe procesin noterial, ndërsa GOE-s që e ka shpallur tani fitues nuk ia ka kontrolluar e as verifikuar fare mekanizmin. Kjo konsiderohet trajtim plotësisht jo i barabartë dhe diskriminues i tenderuesve. Neve na eliminon për kinse çmime jo-normalisht të ulëta pa zhvilluar fare një procedurë interparts për sqarimin e çmimeve të tilla ndërsa GOE-s që e shpallë fitues ia pranon çmimet që janë deri në 7 herë më të larta se çmimet tona dhe ato të tregut. AK në vitet e kaluara kishte buxhetin 3 here më të ulët për shërbimet e njëjta ndërsa këtë vit e ka rritur atë qëllimisht dhe pa asnjë analizë të tregut ku shihet hapur që paralelisht me këtë rritje ia ka përshtatur edhe kërkesat e dosjes së tenderit OE EING COM SHPK dhe se që nga fillimi këtë tender e ka kurdisur që ta fitoj gjithsesi GOE që pas rivlerësimit edhe e ka shpallur fitues. Përpos kësaj ne kemi kërkuar edhe qasje në dokumentet e tenderit të GOE-s fitues dhe AK nuk na ka dhënë as versionin e pastruar të dokumenteve ndërsa kur ky GOE ka kërkuar qasje në dokumentet tona, AK ia ka dhënë të gjitha edhe pse ato ishin të përcaktuara paraprakisht si sekret afarist. Vet fakti që neve na eliminon me arsyetime të pabazuara ndërsa GOE-s që e ka shpallur fitues nuk e merr mundimin as që të ja verifikoj pajisjet dhe makineritë, tregon për favorizim të hapur të tij dhe për diskriminim të qëllimshëm ndaj tenderit tonë. Kjo është dëshmi dhe argument i mjaftueshëm që tregon se AK ka shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së pasi që pa lejen tonë dhe në kundërshtim me deklaratën tonë për sekret afarist, ia ka dhënë GOE-s të shpallur fitues dokumentacionin e tenderit kur ai ka kërkuar qasje në dokumentet tona. Për çudi një veprim të tillë nuk e ka bërë edhe kur ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e këtij GOE andaj veprimi i tillë i AK-së përpos që bie ndesh me nenin 11.3 dhe 11.4 të LPP-së, ky veprim bie ndesh edhe me nenin 7 të LPP -së sepse edhe këtu ka vepruar në mënyrë favorizuese ndaj GOE-s që e ka shpallur fitues. Në këtë rast ndaj neve ka vepruar në mënyrë diskriminuese duke mos na ofruar as së paku versionin e pastruar të dokumenteve siç e parashih neni 11.4 i LPP-së. Nga krejt kjo shihet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 11 të LPP-së i cili flet për ruajtjen e sekretit afarist përkatësisht lejimin në qasje të tenderuesve vetëm tek dokumentet që ligji e përcakton si mundësi dhe mënyrë të lejuar.4. AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderit tonë ka aplikuar kritere që nuk i ka pasur fare të përcaktuara tek kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit. Këtë veprim të AK-së e ndalon rreptësisht paragrafi 3 i këtij nenin i cili shumë qartë e tregon që:

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Kërkesat e aplikuara nga komisioni gjatë ri-vlerësimit si kërkesa shtesë të cilat nuk ishin përcaktuar fillimisht në dosje të tenderit janë:- Kontestimi i referencave të stafit profesional me arsyetimin që kinse ata nuk paskan qenëtë lajmëruar në AKT kur kanë menaxhuar apo punuar në projektet përkatëse që i kishte implementuar kompania që ua ka lëshuar referencat;- Kontestimi i kamionëve cisternë kinse ato nuk janë për ujë edhe pse kërkesa e dosjes së tenderit nuk e përcaktonte një kërkesë të tillë. Ato kërkoheshin të jenë kamion cisternespecial me mekanizëm për larjen e rrugëve dhe si të tilla edhe ishin ofruar;- Kontestimi i peshës së auto fshesës duke e aplikuar peshën totale me ngarkesë edhe pse në dosje ishte kërkuar vetëm: Auto fshese speciale deri në 3 ton për fshirjen errugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit - pa e cekur se për cilën peshë bëhet fjalë;- Kontestimi i lugës ngarkuese deri në 7 ton me arsyetimin se gjoja ajo është e vendosur në traktor! Kjo nuk ishte e përcaktuar askund tek lista e pajisjeve se ku duhet të jetë instaluar luga ngarkuese(në traktor, kamion apo ekskavator) andaj i bie se edhe këtë kriter AK e ka aplikuar si kriter shtesë. Kërkesa ishte kështu: Lugë ngarkuese deri në 7 ton për ngarkim mbeturinave dhe kripës dhe kështu e kemi ofruar. Për më shumë detaje lidhur me hedhjen poshtë të konstatimeve të AK-së si arsye të pabazuara për eliminimin tonë, do ta gjeni tek pika 5. Pra sipas kësaj dhe asaj që do të thuhet tek pretendimi mbi shkeljen e nenit 59 të LPP-së nga ana e AK-së, konstatojmë se kjo e fundit ka shkelur plotësisht nenin 56.3 të LPP-së sepse për eliminimin tonë ka aplikuar kritere dhe kërkesa shtesë që nuk ishin të përcaktuara paraprakisht tek dosja e tenderit.

5. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderit tonë përpos që ka aplikuar kritere shtesë që nuk i kishte të përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit, edhe ato që i kishte nuk i ka aplikuar ashtu si duhet dhe siç ishin kërkuar nga vet AK. Arsyetimi i AK-së për cilësim të tenderit tonë si të papërgjegjshëm duke mos vlerësuar sipas kërkesave të dosjes dhe as sipas rregullave të LPP-së, duket kështu (ne po e paraqesim secilën arsye të eliminimit dhe më pas po e japim sqarimin pse pretendojmë që si arsye nuk është e bazuar): Pretendimi ndaj Arsyës 1 dhe 2 e cila duket kështu:

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. Mungon lista e stafit sipas kërkesës së AK ku decidivisht ka qenë kërkesë e AK – Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, cv, kontratat e punës ose marrëveshjet për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. GO – keni prezantuar si menaxher të projektit z. Besnik Sejdiu ku sipas cv-së së dorëzuar z. Besnik Sejdiu ka qenë i angazhuar që nga viti 2020 si bashkëpunëtor i jashtëm në kompaninë VIA EGNATIA, duke i bashkëngjitur edhe referencat e mirëmbajtjes për periudhën kohore 2020/20022 dhe sipas verifikimit për deklarin e punëtorit nga punëdhënësi sipas linkut të ATK-së rezulton se ky inxhinier nuk ka qenë fare i deklaruar nga e njëjta kompani dhe për AK referenca e یشuar për inxhinierin Sejdiu nga kompania VIA Egnatia është e papranueshme.
2. GO – ka prezantuar si inxhinier të bujqësisë z. Nexhat Maxhuni ku sipas cv-së së dorëzuar shkruan se z. Nexhat Maxhuni ka qenë i angazhuar që nga viti 2021/2022 në kompaninë VIA EGNATIA, duke i bashkëngjitur edhe referencat e mirëmbajtjes për periudhën kohore 2021/22 dhe sipas verifikimit për deklarin e punëtorit nga punëdhënësi sipas linkut të ATKL-së rezulton se ky inxhinier nuk ka qenë fare i deklaruar nga kompania e njëjta kompani dhe për AK referenca e lëshuar për inxhinierin Maxhuni nga kjo kompani është e papranueshme. Si përfundim ky GO nuk ka arrit të plotësoj kërkesat e AK sipas udhëzuesit Nr 001/2023 për prokurimin publik neni 69 i LPP-së, cv e dorëzuar për inxhinierët nuk përmbushin kërkesat e dosjes së tenderi/ refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm

Sipas këtyre dy arsyetimeve AK e ka kontestuar listën e stafit profesional si dhe referencat e inxhinierit të komunikacionit dhe inxhinierit të bujqësisë. Lista e stafit profesional nuk është dorëzuar me arsyetimin se kanë qenë vetëm dy persona si staf profesional të kontraktuar dhe është e pakuptueshme të bëhet lista me vetëm dy anëtar të jashtëm kur të dy i kanë pasur të dorëzuara vendimet e veçanta për angazhim në pozitat e tilla në projekt si dhe të gjitha dëshmitë tjera të kërkuara. Përpos kësaj sipas UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, AK është dashur të na kërkoj sqarime për listën e tillë me që për personat në fjalë i kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë tjera të kërkuara siç janë vendimi, diploma, kontrata, CV dhe referencat. Ja si e përshkruan udhëzuesi 001/2023 këtë veprim që AK ka mundur ta bëjë:

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve		
10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së		
Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
	⋮	⋮
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon Certifikata e	Mund të kërkohen informata	

Me që LPP, RRPP-001/2022 e as Udhëzuesi 001/2023 nuk e trajtojnë sakt se si duhet vepruar në rast se mungon lista e stafit profesional ndërsa dëshmitë tjera të kërkuara janë dorëzuar, atëherë AK duhet ta aplikoj këtë udhëzim/dispozitë si dhe duhet aplikoj edhe nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së. Pra po shihet se Udhëzuesi shumë qartë po e përcakton se kur referencat lidhur me kërkesën janë të dorëzuara dhe mungon vetëm lista, atëherë AK duhet të kërkoj sqarime shtesë. Po ashtu sipas nenit 59.4 dhe nenit 72 të LPP-së një sqarim i tillë është dashur edhe të bëhet pasi që i njëjti nuk ndikon aspak në ndonjë ndryshim substancial të tenderit. Të eliminohet një tenderues pse nuk e posedon listën stafit profesional që edhe ashtu do të përbëhej vetëm nga dy persona dhe të

shpërblehet me kontratë një GOE tjetër me çmim 71.82% më të shtrenjtë, është hipokrizi dhe kulmi i shpërdorimit të parasë publike. Kjo jo vetëm që është në kundërshtim me LPP-në por është plotësisht në kundërshtim edhe me Ligjin për Administrimin e Financave Publike. Pjesa tjetër e këtij arsytimi të pabazuar për eliminim është ajo kinse që këtyre dy personave nuk duhet me ua pranuar referencat për projektet e implementuara sepse ata nuk kanë qenë të lajmëruar në ATK në rastin e angazhimit si bashkëpunëtor të jashtëm tek kompania që ua ka lëshuar referencat. Tek kërkesat e dosjes së tenderit, si dëshmi për këta dy inxhinier ishin kërkuar: diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për ti plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referencë nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitat e kërkuara. Në bazë të kësaj po shihet hapur se kërkesa askund nuk ka qenë e përcaktuar se stafi i tillë duhet të ketë qenë i lajmëruar në ATK andaj aplikimi i këtij kriter përpos që është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, konsiderohet edhe aplikimi si kriter shtesë që sipas nenit 56.3 të LPP-së është i ndaluar. Këtë aplikim si kriter shtesë e bënë edhe më të paligjshëm fakti që për të qenë i angazhuar në një projekt të një kompanie nuk nënkupton detyrimisht të jesh në listën e pagave të asaj kompanie sepse dihet që ka shumë mënyra të kontraktimit për të qenë i angazhuar në një projekt siç edhe kanë qenë të angazhuar personat në fjalë.

Pretendimi ndaj Arsyës 3 e cila duket:

3. Tek lista e pajisjeve – kërkesë e AK ka qenë kamion cisternë me mekanizëm komplet për larje të rrugëve me vëllim mbi 7000l (kamion cisterna duhet të ketë mekanizëm për larje nga ana e përparme dhe e prapme me puntor) sasia 3 copë .
GO për këtë pikë ka ofruar vetëm një cisternë sipas kërkesës së AK-së, dmth nuk ka arrit të plotësoj kërkesën e AK_së për më tepër ka vënë në lajthitje komisionin në teren duke i prezantuar cisternë që nuk ka qenë fare e prezentuar sipas Aneksit 7
Sipas marrëveshjes me OE Papenburg & Adriani Kompani, 01-301-SB, 01-893-SR nuk janë cisterna sipas kërkesës së AK-së, sepse cisterna e prezantuara janë për transport të naftës ndërsa 01-853-SM nuk plotëson specifikat e kërkuara.
Cisterna sipas marrëveshjes me OE Kosova Asphalt, 05-655-EN nuk është sipas kërkesës së AK-së sepse nuk ka mekanizëm për larje nga ana e përparme dhe nga ana e pasme.
Makineria me targa 01-956-KB nuk është fare cisternë por e njëjta është autofshisë për larje të rrugëve . Kërkesa ka qenë autofshisë speciale deri 3t për fshirjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit. GO për këtë pikë ka ofruar autofshisë me peshë 3.5t, gjë që nuk i plotëson kërkesat e AK-së
Tjetër kërkesë ka qenë: lugë ngarkuese deri në 7t. Për largimin e mbeturinave dhe kripës – 2 copë. GO për këtë pikë ka ofruar vetëm një lugë ngarkuese 01-824-ZM, ndërsa pajisjet në aneksin 7 të cekura nga GO dalin të jenë traktor me kabinë , bager JCB 3CX, bager JCB 3CX 4X4 prandaj asnjëra nga makineritë e cekura nuk janë konform kërkesave të AK.

Arsyetimi për eliminim se gjoja ne nuk kemi ofruar cisternat sipas kërkesës së AK-së është plotësisht i pabazuar pasi që ne kemi ofruar 6 kamion cisternë nga të cilat së paku 3 i plotësojnë kriteret e kërkuara nga AK, ndërsa 3 tjera i kemi vendosur vetëm si pajisje rezervë me të cilat

AK nuk ka pas nevojë të merret fare. Arsyetimi tjetër që gjoja ne kemi vënë komisionin inspektues në lajthitje, është arsyetim jo parimor dhe jo etik i cili nuk qëndron fare sepse inspektuesit i kanë pasur me vete dëshmitë siç janë librezat e regjistrimit dhe listën e pajisjeve që ne i kemi dorëzuar në tender nga ku lirisht kanë mundur të i krahasojnë ato me tabela përkatësisht me numra të shasive tek secila pajisje. Ky konstatim se gjoja ne nuk u kemi ofruar pajisjet e nevojshme është shpifje dhe akuzë plotësisht e pabazuar për të cilën besojmë se AK do jap llogari para instancave hetuese që do të merren me këtë çështje. E themi këtë sepse nuk është aspak e vërtetë ajo që thuhet, pasi që realisht ne u kemi dhënë qasje të pakushtëzuar në të gjitha pajisjet duke ua sqaruar çdo kërkesë të tyre dhe duke u dhënë çdo informatë që ata e kanë kërkuar. Tek fotot që komisioni i verifikimit i ka shfrytëzuar për vlerësim shihen edhe pajisje që nuk kanë qenë të paraqitura fare në tenderin tonë andaj kjo përpos që tregon për mashtrim nga ana e komisionit të tillë, tregon edhe faktin sa joprofesional kanë qenë. Komisioni i tillë qëllimisht ka fotografuar pajisje tjera sa për të manipuluar gjatë vlerësimit andaj kjo tregon se ky komision e ka keqpërdorur mundësinë e dhënë duke fotografuar pajisje të ndryshme me apo pa tabela të cilat nuk janë pjesë e projektit dhe tenderit tonë. Në pllacin tonë ka me qindra pajisje të ndryshme nga të cilat disa janë në proces të servisimit e disa ende të pa regjistruara andaj paraqitja e tyre kinse nuk janë të rregullta edhe pse ne nuk i kemi dorëzuar fare si pajisje në tenderin tonë, konsiderohet shkelje e rëndë e besimit dhe e detyrës zyrtare për çka ishin caktuar ai komision. Vlen të sqarohet se disa makinerive qëllimisht u hiqen tabelat nga vendi dhe vendosen diku brenda në kabinë dhe jo domosdoshmërisht në vend të dukshëm pasi që gjatë procesit të largimit të borës ato shpesh shpesh shpesh shpesh nga vendi dhe humbin. Për këtë veprim as policia rrugore nuk krijon problem sepse ato ne veç i kemi me vete dhe nuk përbën asnjë lloj shkeljeje. Komisioni është dashur që për të i verifikuar pajisjet e tilla të ua kontrolloj numrat e shasive sepse ato janë elementet e sigurisë që nuk mundën të ndryshohen dhe tregojnë saktë kush pajisje cilës librezë qarkullimi i përket. Kjo tregon shumë për jo profesionalizmin dhe naivitetin e tyre ku pikërisht mbi bazën e këtij konstatimi nga këta "ekspert", AK pa asnjë bazë ligjore e ka kontestuar aktin noterial të noterit i cili i ka kontrolluar dhe verifikuar makinat një për një duke ua verifikuar secilës numrin e shasisë sipas procedurës en-minutes. Tejkalmimi i kompetencave apo shtrembërimi i të vërtetës përmes fotografive, sipas KPRK-së konsiderohet vepër penale e cila edhe do të sanksionohet pasi të konstatohet e vërteta nga organet kompetente. AK nuk është dashur të bazohet vetëm në foto sepse ato në këtë rast janë të manipuluar por është dashur të bazohet në vërtetësinë e numrave të shasisë të pajisjeve të cilat janë të vërtetuara edhe nga noteri. Shtrohet pyetja mos vallë kontestimi i procesit noterial ishte i qëllimshëm për t'u përdorur si shkas për dalje në verifikim i cili si proces nuk ishte i parashikuar fare në dosjen e tenderit? Se cilat makineri janë dorëzuar nga ne dhe cilat i ka paraqitur komisioni si shtrembërim i realitetit do të duhej ta sqaroj ekspertit shqyrtues të cilin e ftojme që ta bëjë këtë me të vetmin qëllim sqarimin e krejt mashtrimit të

paraqitur nga AK-ja përkatësisht nga komisioni verifikues.

Edhe konstatimi tjetër që gjoja disa cisterna janë për transportin e naftës nuk është aspak e vërtetë. Pavarësisht kësaj dhe me që kamionët cisternë me tabelë 01-301-SB, 01-893-SR dhe 01- 853-SM i plotësojnë mjaftueshëm kriteret e kërkuara nga AK dhe numri i kamionëve cisternë që janë kërkuar ishte vetëm 3 copë, atëherë tregon se arsyetimi i AK-së për pajisje që nuk janë kërkuar është i trilluar dhe nuk përkon me realitetin e as me mënyrën e vlerësimit të kriterëve kualifikuese pasi që shihet se ne e kemi plotësuar kushtin plotësisht ashtu siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit. Ne jemi të sigurt se edhe dy kamionë cisternë të tjerë që ndodhen në listë e plotësojnë kushtin e kërkuar por me që kriteri i tillë është plotësuar mjaftueshëm me tre kamionët cisternë të cekur më lartë, nuk po e elaborojmë çështjen më shumë. OSHP posedon të gjitha dëshmitë (librezat, marrëveshjet, fotot, procesin e noterizimit etj.) në tenderin tonë me të cilat mund të bindet lehtë se kamionët e tillë janë plotësisht sipas kërkesave të AK-së por në rast se e shohin të nevojshme për të pasur pasqyrë reale të gjendjes, OSHP mundet që të i verifikoj në çdo kohë përmes ndonjë ekspertit teknik i cili do duhej të ishte me profesion nga natyra adekuate e kontestit. AK ngjashëm i ka kontestuar edhe auto fshesën kinse nuk e posedon peshën e kërkuar, mirëpo kjo nuk qëndron sepse kërkesa ishte të ofrohet: Auto fshese speciale deri në 3 ton për fshirjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit ndërsa ne e kemi ofruar fshesën me peshë 1850kg që shihet se e plotëson kërkesën e AK-së.

9D82	G	Pesha e automjetit; Masa vozitira; Mass of the vehicle:	1850
	K	Homologimi; Хомологација; Type of approval:	

AK ka kontestuar edhe lugën ngarkuese duke dhënë arsye të pabazuara gjoja se njëra nga lugët ngarkuese të paraqitura nga ne është traktor. Me që kërkesa e AK-së ka qenë që ë ofrohet: Lugë ngarkuese deri në 7 ton për ngarkim mbeturinave dhe kripës – dhe askund nuk e ka potencuar se ku duhet të jetë e instaluar luga, tregon se pajisja në të cilën thirret AK e plotëson mjaftueshëm kushtin (shiko pajisjen 01-371 VB). Pavarësisht kësaj ne i kemi ofruar edhe dy pajisje tjera të huazuara (me qera) të cilat janë të tipit JCB 3CX dhe JCB 3CX 4x4 me targa TE 8642 AH dhe TE 2307 AB të cilat i plotësojnë tërësisht kërkesat e dosjes së tenderit. Sipas kësaj del që arsyetimi i AK-së për mangësi në pajisje të jetë komplet i pabazuar dhe se ne i

plotësojmë të gjitha kriteret për tu cilësuar si GOE me tender të përgjegjshëm.

Pretendimi ndaj Arsyes 4 e cila duket:

4. AK – konsideron se tenderi juaj është jo normalisht i ulët për shumicën e pozicioneve në objektin e kontratës sepse oferta juaj është mbi 40% më e ulët se vlera e parashikuar.

Këto janë disa krahasime nga oferta financiare që konsiderohet tender jo-normalisht i ulët:

- III TABELA C (FURNIZIME DHE SHËRBIME

- 1. FURNIZIMI ME KRIPË

Njësia	sasia	çmimi	shuma
Ton	625	35€	21875€

Ku e dim se 1 ton krip në treg sipas hulumtimeve kushton nga 75-80 euro

- 6 INTERVENIMI ME MAKINERI TE RENDE SI (FREZA BORE, NGARKUES) NE ZONAT E THELLA MALORE NE RASTE KUR MUND TE INTERVENOHET ME MAKINERI TJERA.

Njësia	sasin	çmimi	shuma
orë	320	5.0€	1200.0€

Ju keni ofruar një çmim prej 5.0€ për orë për makineri të rëndë, kur ne e dim se një orë pune me makineri të rëndë kushton mbi 50€ ora.

TABELA A

KATEGORIA –I-

Fshirja (26) ditë në muaj,
Larja (4) here në muaj
Largimi i borës sipas rezhjeve

I. RRUGA ZAHIR PAJAZITI

a) Rruga			
njësia	sasia	çmimi	totali
m ²	11989	0.015	179.83€

b) Trotuari			
njësia	sasia	çmimi	totali
m ²	5109	0.01	51.09€

Ju keni ofruar çmimin mujor prej 0.015€ /m² për 26 fshirje, për 4 larje dhe pastrimin e borës sipas reshjeve për rrugën me 11989m² dhe 0.01€ /m² për trotuare prej 5109m² që në total kapin vlerës 230,93€/muaj duke marrë parasysh shpenzimet e makinerisë, fuqisë punëtore të angazhuar etj, është i paarrtshëm .

Oferta juaj nëse krahasohet me objektin e kontratës ka dallime substancionale në raport me çmimet e tregut dhe si e tillë konsiderohet ofertë e papërgjegjshme

Ky arsyetim i AK-së me të cilin shihet se i ka kontestuar disa nga çmimet tona si jo normalisht të ulëta është plotësisht i pabazuar dhe shumë jo-profesional. E themi se është i pabazuar dhe jo profesional pasi që AK nuk ka arritur të argumentoj konstatimin dhe se për të ardhur deri te eliminimi sipas këtij kriteri është dashur të veproj fillimisht sipas nenit 61 të LPP-së, 41 të RRP-001/2022 si dhe sipas nenit 11 të UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Këtë veprim nuk e ka bërë andaj lirisht mund të thuhet se përpos shkeljes së këtyre neneve, AK ka shkelur edhe nenin 59 të LPP-së. Këtë arsyetim të pabazuar të AK-së e gjeni të zgjeruar tek pretendimi lidhur me shkeljen e nenit 61 të LPP-së. Nisur nga krejt kjo që e thamë më lartë, shihet se me rastin e vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve, AK dhe komisioni i vlerësimit kanë shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.6. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me LPP-në dhe si pasojë e kësaj ka shpërblyer me kontratë një GOE që posedon çmimin më të lartë se ne për 71.82% përkatësisht për 237,223.83€. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e të gjitha dispozitave që flasin për administrimin e drejtë të parasë publike si dhe konsiderohet shkelje e plotë edhe e

kriterit të vlerësimit i vendosur në përputhje me nenin 60 të LPP-së që ishte - Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

7. AK ka shkelur nenin 61 të LPP-së gjatë vlerësimit të tenderit tonë pasi që kontestimi i çmimeve tona si çmime jo-normalisht të ulëta përpos që është i pabazuar, i njëjti nuk është bërë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe 41 të RRPP-001/2022. Këtë e themi sepse AK fillimisht është dashur të hulumtoj çmimet e tregut e pastaj të na kërkoj sqarime sipas paragrafit 2 të nenit 61 të LPP-së ndërsa vendimin për çmimet e tilla ta merr tek pas konsiderimit të përgjigjes tonë të ofruar sipas paragrafit 6, 7, 8, 9 dhe 10 të nenit 41 të RRPP-001/2022. Para se të ua kujtojmë çka thonë këto dispozita, duam të ju sqarojmë që për të cilësuar tenderin tonë si tender jo-normalisht të ulët fillimisht duhet plotësohen tre kushtet e nenit 41.3 të RRPP- 001/2022 si apo tre kushtet e nenit 11 të UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Asnjëri nga këto tre kushte nuk është plotësuar andaj konstatimi i AK-së që tenderi jonë është tender jo-normalisht i ulët është komplet i pabazuar dhe jo ligjor. Përpos kësaj edhe sikur vetëm ndonjëri nga çmimet të duket si jo-normalisht i ulët atëherë prapë sipas nenit 41.4 të RRPP-001/2022, AK duhet që fillimisht të na kërkoj sqarime dhe vetëm pas përgjigjes tonë, të ndërmerr masat e eliminimit nëse nuk arrin të bindet me sqarimet tona. Ja si e përshkruan detyrimin e AK-së paragrafi 2 i nenit 61 të LPP-së dhe neni 41.5 – 41.9 i RRPP-001/2022:

Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

- 2.1. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Ndërsa nenin 41 i RRPP-001/2022 e thotë që:

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zberthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët".

41.7 Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- a. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

41.10 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

- a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose
- b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit.

AK përpos që nuk i ka respektuar dispozitat e cekura më lartë, nuk ka arritur as të jap ndonjë argument të besuar dhe të qëndrueshëm se çmimet tona janë jo-normalisht të ulëta. AK në vend se të sqaroj çmimet jo normalisht dhe ekstremisht të larta të GOE të shpallur fitues, merret me

çmimet tona që janë plotësisht reale dhe njëkohësisht ja kursejnë buxhetin për më shumë se 70% në krahasim me GOE të shpallur fitues. Kjo tregon hapur favorizimin e GOE të shpallur fitues dhe ngritë dyshimin për lidhjet e fshehta si dhe interesat personale që mund të ketë zyra e prokurimit së bashku me komisionin vlerësues në shpalljen si fitues të këtij GOE. Është shumë e çuditshme edhe arsyetimi i AK-së në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim që thotë ne e dimë se çmimet janë të jo normalisht të ulëta dhe nuk kemi pasur nevojë për sqarim nga OE. Ky veprim është plotësisht i paligjshëm dhe tregon mirë neglizhencën dhe shpërfilljen e ligjit të prokurimit nga ky AK përkatësisht nga zyra e prokurimit. Vlen të thuhet se ka dyshime që AK qëllimisht e ka fryrë(ritë) çmimin në parashikimin e buxhetit duke ia përshtatur më pas edhe kriteret e përzgjedhjes GOE që gjatë rivlerësimit e ka shpallur fitues. Vetëm krahasoni vlerën e parashikuar të tenderit të ngjashëm në dy tre vitet e kaluara dhe do të bindeni se a e kanë përcaktuar saktë buxhetin që mendojnë ta shpenzojnë apo më mirë të themi të e keq përdorin. Tani për tani nuk po japim sqarim detal për çmimet e kontestuara si jo normalisht të ulëta por nëse OSHP ka nevojë që të bindet se ato janë çmime normale të tregut, mundet të na kërkoj sqarime në çdo kohë. Sipas krejt kësaj po shihet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 61 të LPP-së, nenin 41 i RRPP-001/2022 dhe nenin 11 të UPP-001/2023.

8. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat e projektit. AK ka vendosur shumë kriteret dhe kërkesa që lidheshin me nenin 69.4 të LPP-së por që asnjërin nga këto kriteret nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Shumicën e këtyre kriterëve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit të shpallur fitues ndërsa të njëjtat kriteret i ka keq aplikuar dhe i ka keqinterpretuar kur bëri ri-vlerësimin e tenderit tonë. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69.4 të LPP-së, kemi të bëjmë edhe me favorizim të GOE të shpallur fitues dhe me diskriminim të grupit tonë si tenderues i përgjegjshëm me të gjitha dëshmitë e ofruara. 9. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit sepse nuk ka kërkuar fare sqarime për disa paqartësi që shihet se i ka pasur tek tenderi jonë por pavarësisht kësaj ka vepruar në mënyrë arbitrare pa u siguruar me gjendjen reale duke na eliminuar për mangësi që do duhej sqaruar detyrimisht. Shumë qartë tregohet në nenin 72 i LPP-së, në nenin 38 të RRPP- 001/2022 si dhe në nenin 10 të UPP-001/2023 se si duhet vepruar për të sqaruar mangësitë, dhe paqartësitë në tenderët konkurrues. Në vazhdim po paraqesim vetëm atë që e kërkon nenin 72 i LPP për sqarim të tenderëve:

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Nga krejt procesi preliminar i zgjidhjes së kontestit shihet se AK ka manipuluar me prova dhe shprehje edhe gjatë procesit të kthimit të përgjigjes në pretendimet tona të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim sepse askund nuk iu ka përmbajtur pretendimeve tonë gjatë arsyetimit të përgjigjeve. Shihet hapur se profesionalisht përgjigjet janë të mangëta, AK i ka ikur përgjigjeve direkte duke tentuar të kamufloj përgjigjet me shprehje si "ne jemi të bindur", "komisioni ka vepruar mirë", "pretendimet janë të përsëritura" etj. që tregon se fillimisht ata nuk i kanë kuptuar si duhet pretendimet e mandej kanë dhënë përgjigje jo profesionale por edhe tendencioze. Në disa raste është thirrur në prova që nuk lidhen fare me tenderin tonë e shpesh i ka përzier gjërat duke provuar të arsyetoj gabimet dhe shkeljet e veta të bëra gjatë rivlerësimit. Me që ne nuk kemi pasur qasje në tenderin e GOE të shpallur fitues që të bindemi se i plotëson kërkesat e dosjes për tu cilësuar i përgjegjshëm, kërkojmë nga eksperti shqyrtues ta bëjë vlerësimin e përgjegjshmërisë të tij karshi kërkesave të dosjes së tenderit.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

plotësisht reale dhe njëkohësisht ja kursejnë buxhetin për më shumë se 70% në krahasim me GOE të shpallur fitues. Kjo tregon hapur favorizimin e GOE të shpallur fitues dhe ngritë dyshimin për lidhjet e fshehta si dhe interesat personale që mund të ketë zyra e prokurimit së bashku me komisionin vlerësues në shpalljen si fitues të këtij GOE. Është shumë e çuditshme edhe arsyetimi i AK-së në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim që thotë ne e dimë se çmimet janë të jo normalisht të ulëta dhe nuk kemi pasur nevojë për sqarim nga OE. Ky veprim është plotësisht i paligjshëm dhe tregon mirë neglizhencën dhe shpërfilljen e ligjit të prokurimit nga ky AK përkatësisht nga zyra e prokurimit. Vlen të thuhet se ka dyshime që AK qëllimisht e ka fryrë (rritë) çmimin në parashikimin e buxhetit duke ia përshtatur më pas edhe kriteret e përzgjedhjes GOE që gjatë rivlerësimit e ka shpallur fitues. Vetëm krahasoni vlerën e parashikuar të tenderit të ngjashëm në dy tre vitet e kaluara dhe do të bindeni se a e kanë përcaktuar saktë buxhetin që mendojnë ta shpenzojnë apo më mirë të themi të e keq përdorin.

Tani për tani nuk po japim sqarim detal për çmimet e kontestuara si jo normalisht të ulëta por nëse OSHP ka nevojë që të bindet se ato janë çmime normale të tregut, mundet të na kërkoj sqarime në çdo kohë. Sipas krejt kësaj po shihet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 61 të LPP-së, nenin 41 i RRPP-001/2022 dhe nenin 11 të UPP-001/2023.

8. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat e projektit. AK ka vendosur shumë kritere dhe kërkesa që lidheshin me nenin 69.4 të LPP-së por që asnjërën nga këto kritere nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Shumicën e këtyre kritereve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit të shpallur fitues ndërsa të njëjtat kritere i ka keq aplikuar dhe i ka keqinterpretuar kur bëri ri-vlerësimin e tenderit tonë. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kritereve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69.4 të LPP-së, kemi të bëjmë edhe me favorizim të GOE të shpallur fitues dhe me diskriminim të grupit tonë si tenderues i përgjegjshëm me të gjitha dëshmitë e ofruara. 9. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit sepse nuk ka kërkuar fare sqarime për disa paqartësi që shihet se i ka pasur tek tenderi jonë por pavarësisht kësaj ka vepruar në mënyrë arbitrare pa u siguruar me gjendjen reale duke na eliminuar për mangësi që do duhej sqaruar detyrimisht. Shumë qartë tregohet në nenin 72 i LPP-së, në nenin 38 të RRPP- 001/2022 si dhe në nenin 10 të UPP-001/2023 se si duhet vepruar për të sqaruar mangësitë, dhe paqartësitë në tenderët konkurrues. Në vazhdim po paraqesim vetëm atë që e kërkon nenin 72 i LPP për sqarim të tenderëve:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “VIA EGNATIA SH.P.K.; NNSh VAAKAL; Natyra” lidhur me tenderin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve”.

ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e AK – KOMUNA E PODUJEVËS dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM. Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të LPP-së ku më pas do duhej që Fitues të shpallej OE “VIA EGNATIA SH.P.K.; NNSh VAAKAL; Natyra”.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 1,200,000.00 Euro	Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme në vlerë minimale prej 900,000.00 Euro, në 3 (tre)	Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe

		<p>vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar në punë të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit</p>	<p>datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.</p>
		<p>OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt përveq stafit të diplomuar – certifikuar OE duhet të ketë min. 20 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve.</p> <p>a) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip.i Komunikacionit - minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1(një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga vet ai dhe kompania b) Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion. Të ketë së 1 referenca të udhëhequr të natyrës së njëjtë). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania</p>	<p>Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për ti plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referencë nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitë të kërkuara. Për stafin teknik - kontratat e punës ose parakontrata valide në kohëzgjatje të kontratës</p>
		<p>Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT</p>	<p>Duhet të ofrohet një listë e pajisjeve sipas Aneksit 7 të DT e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes, duke i bashkëngjitur librezat e regjistrimit me validitet për të gjitha makinerit nga 1 – 12, ndersa nga 13-15 mund të ofrohen me dud ose faturë. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me kohëzgjatje të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët, duhet të jete e</p>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve” me numër të prokurimit: “615-23-4993-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS

			noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës
		Licenca e MMPH për administrimin e mbeturinave	Licenca e lëshuar nga MMPH për natyrën e kontratës - valide
		Kontrata e KMDK për deponimin e mberurinave	Kontratë me KMDK për hedhjen e mbeturinave - valide
		Plani i veprimit për kryerjen e shërbimeve sipas specifikacionit teknik të DT	Plani duhet të jetë i përgatitur në mënyrë sa më të detajuar, i nënshkruar dhe vulosur
		OE është i obliguar që vendparkimin për makinerinë e sezonit verorë dhe dimëror ta ketë në territorin e Komunës së Podujevës - jo më larg se 10 km nga qyteti.	Dëshmi fleta poseduese ose marrëveshja për marrje në shfrytëzim, marrëveshja duhet të jetë e noterizuar

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

1.Grup i Operatorëve Ekonomik VIA EGNATIA SH.P.K.; NNSh VAAKAL; Natyra

GOE nuk ka dorezuar listen e stafit sipas kërkeses së AK ku decidivishte ka qen kërkes e AK :

Lista e stafit profesional sebashku me Diplomat,CV,kontratrat e punes ose marveshjet per bashkpunim ne kete projekt deshmte mbi pervojten e punes.

GOE ka prezentuar si menagjer te projektit z Besnik Sejdiu ku sipas Cv-se se dorezuar shkruan se z Besnik Sejdiu ka qen i angazhuar qe nga vit 2020 si bashkpuntore i jashtem ne kompanin VIVA EGNATIA SHPK, duke i bashkangjitur edhe referencat e mbirmbajtes per prejjudh kohore 2020/22 dhe sipas verifikimi per deklarimin e puntorit nga punedhensis sipas Linkut te ATK-se rezulton se ky Inxhinier nuk ka qen fare i deklaruar nga kompania VIA EGNATIA SHPK, dhe per ne komisioni per vlersimin e ofertave referenca e leshuar per injninerin Sejdiu nga kompania VIA EGNATIA SHPK eshte e pa pranushme.

2.GOE ka prezentuar si inxhinier te bujqesis z Nexhat Maxhuni ku sipas Cv-se se dorezuar shkruan se z Nexhat Maxhuni ka qen i angazhuar qe nga viti 2021/22 ne kompanin VIVA EGNATIA SHPK, duke i bashkangjitur edhe referencat e mbirmbajtes per prejjudh kohore 2021/22 dhe sipas verifikimi per deklarimin e puntorit nga punedhensis sipas Linkut te ATK-se rezulton se ky Inxhinier nuk ka qen fare i deklaruar nga kompania VIA EGNATIA SHPK, dhe per ne komisioni per vlersimin e ofertave referenca e leshuar per injninerin Maxhuni nga kompania VIA EGNATIA SHPK eshte e pa pranushme.

Si perfundim ky GOE nuk ka arrit ta plotesoj kërkesen e AK sipas udhezuesit NR 001/2023 per prokurimin publik neni 69 i LPP-se , Cv e dorezuar per inxhinierat nuk permbushin k erkesat e dosjes se tenderit / refuzo tenderin pa kerkuar informacion te metejshem.

-Kërkesa ka qen; KAMION cisterna me mekanizem kompler per larje te rrugeve me veillim mbi 7000 l (kamion cisterna duhet te ket mekanizen per larja nga ana e perparem dhe e prapme me puntore) sasia 3 cop

GOE per kete pike ka ofruar vetem nje cistern sipas kërkeses se AK-se , nuk ka arrit te plotesoj kërkesen e AK-se per me teper ka ven ne lajthitje komisionin ne teren duki i prezentuar Cisterna qe nuk kan qen fore te prezentuara sipas Aneksit 7.

Cisterna sipas marveshjes K.N.P.SH.

PAPEMBURG DHE ADRIANI KOMPANI SH.P.K 01-301-SB, 01-893-SR nuk jan cisterna sipas kërkeses se AK-se , sepse keto cisterna jane per transport te naftes ndersa 01-853-SM nuk ploteson specifikat e kerkuara.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve” me numër të prokurimit: “615-23-4993-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS

Cisterna sipas marveshjes me Kosova Asfaltit sh.p.k 05-644-EN nuk eshte sipas kerkeses se AK-se sepse nuk ka mekanizem per larje nga ana e perparme dhe nga ana e prapeme.

Makineria me targa 01-956-KB nuk eshte fare cistern por e njejta eshte autofshis per larjen e rrugeve.

Kerkes ka qen autofshis speciale deri 3T per fshirjen e rrugeve trotuareve dhe shesheve te qytetit.

GOE per kete pike ka ofruar autofshis me pesh 3.5 T gje qe nuk i ploteson kerkesat e AK-se.

Kerkesa ka qen ; lug ngarkuese deri ne 7 t per largim te mbeturinave dhe kripes 2 cop.

GOE per kete pike ka ofruar vetem nje luge ngarkuese 01-824-ZM ndersa pajisjet ne aneksin 7 te cekura nga GOE dalin te jen traktore me kabin traktor me kabin,bager JCB 3CX , bager JCB 3CX 4X4 prandaj asnjera nga makinerit e cekura nuk jane konform kerkeses se AK-se.

DEKLARATË

Pas vlersimit,krahasimit të të gjitha ofertave të DT, komisionin rekomandon se OE Grup i Operatorëve Ekonomik EING COM SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.te shperblehet me kontratë.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Emaili i dates 25.12.2023 drejtuar AK-se

Emaili i dates 26.12.2023 drejtuar OE ankues

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - VIA EGNATIA SH.P.K.

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka te bëjë me shkelje të nenit 1 dhe 6 dhe arsyetimin e çmimit te lartë bazuar në paramasën e dosjes se tenderit pozicioni Mirëmbajtja dimërore pozicioni 1 Largimi i borës dhe akullit ne rrugët e fshatrave eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë përgjigjes ndaj kërkesës për rishqyrtim nuk e ka arsyetuar refuzimin e pretendimit bazuar ne dëshmitë te dokumentuar

por qe ka dhënë një përgjigje te përgjithshme.

Duke u bazuar ne paramasë për mirëmbajtje dimërore është parapare sasia prej 2496315.94 m² derisa çmimi i dhënë është për 24 ore.

Ne paramasë te vërejtje është përcaktuar se:

1.Çmimi llogaritet në bazë të sipërfaqeve konkrete (m² të pastruara), brenda 24 orëve, edhe nëse është e nevojshme të intervenohet disa herë brenda ditës.

Prandaj pretendimi i OE ankues ne lidhje me llogaritjen nuk është i sakte sepse me paramasë është e përcaktuar qartë se si behet faturimi kështu që pretendimi i OE ne këtë **pikë nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me verifikimin e pajisjeve ne terren eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT

Duhet të ofrohet një listë e pajisjeve sipas Aneksit 7 të DT e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes, duke i bashkangjitur librezat e regjistrimit me validitet për të gjitha makinerit nga 1 – 12, ndersa nga 13-15 mund të ofrohen me dud ose faturë. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me kohëzgjatje të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës

OE ankues ka dorëzuar listën e pajisjeve te noterizuar nga noteri sipas kërkesës se AK-së. AK përkundër faktit se ne vlerësimin e parë e kishte rekomanduar për kontrate OE ankues, pas kërkesës për rishqyrtim nga OE i dyte AK-ja e ka kthyer tenderin në rivlerësim. Përkundër faktit se kërkesa e dosjes se tenderit si dëshmi është kërkuar qe lista e pajisjeve te dorëzohet përmes procedurës "en minutes" nga noteri AK-ja kishte vendosur qe ta bëjë verifikimin ne terren për OE ankues. Sipas dosjes se tenderit PJESA A kërkesa 9.3 AK-ja ka të drejtë që të bëjë verifikimin e kompanive të OE për qëllime të verifikimit.

Eksperti shqyrtues përmes kërkesës për sqarim ka kërkuar nga AK ti ofrohet procesverbali i minutave te komisionit ne terren me gjetjet e përshkruara ne raportin e rivlerësimit dhe njoftimin për vendim por qe AK-ja nuk e ka ofruar asnjë dokument apo nuk e ka konfirmuar se është mbajtur ndonjë procesverbal.

Për me tepër te njëjtat pyetje i janë bërë edhe OE ankues i cili e ka dëshmuar se komisioni i vlerësimit i ka dhënë vetëm një ditë afat për vizitën ne terren dhe verifikimin e pajisjeve përkundër faktit se ne ofertën e OE ankues kanë qenë tepërfshira edhe pajisje te cilat janë marre ne shfrytëzim me marrëveshje nga vendi fqinj dhe OE tjerë.

Një gjë të tillë nuk e kishte aplikuar edhe për OE te rekomanduar për kontratë. Ne përgjigjen e dhënë në vendimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 06.12.2023 e AK e kishte arsyetuar këtë pretendim se **"nuk ka pas nevojë për verifikim te makinerive te OE të rekomanduar për kontratë sepse kanë qenë të qarta sipas dëshmimeve të prezantuara me rastin e ofertimit"**.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë rivlerësimit dhe vendimit që të verifikohen vetëm pajisjet e një OE pjesë e aktivitetit të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 1 dhe 6 të LPP-se.

Eksperti shqyrtues gjatë administrimit të provave (listës së pajisjeve të OE të rekomanduar për kontratë) në kërkesën 1 **Kamion cisterna special me mekanizëm komplet për larje të rrugëve të jetë me vëllim mbi 7000 Litra. (Kamion cisterna duhet të ketë mekanizmin për larje nga ana e përparme dhe nga ana e prapme me punëtorë) – 3 copë**

Noteri në aktin e noterizimit e ka përfshirë kamionin cisterne special me mekanizëm komplet për larje të rrugëve me vëllim mbi 7000 l me nr regjistrimit **06 792 DF SCANIA me nr 4263307** derisa për të njëjtin nuk është dorëzuar dëshmia dhe nuk është përfshirë librezja e regjistrimit.

OE i rekomanduar për kontratë për të njëjtin pozicion ka dorëzuar dëshmi për kamionin me targa **06 331 EB** e cila nuk është e përfshirë në aktin noterial dhe nuk mund të pranohet.

Për kërkesën **15. Makinë për bluarjen e degëve paskrasitjes.**

Noteri e ka përfshirë në aktin noterial makinë për bluarjen e degëve pas krasitjes të tipit RAMBO HC10-1 sipas DUD- R 25870 i datës 14.10.2020 për të cilën nuk është dorëzuar dëshmia DUDI si i përshkruar më lartë.

Vlen të theksohet se edhe në ofertën e OE ankues të lista e kërkesave 1 OE ankues nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për plotësimin e kërkesës sipas dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues poashtu vlerëson se për kërkesën 6 “Auto fshesespeciale derinë 3 ton për fshirjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit” AK-ja nuk i ka trajtuar njëjtë dëshmitë e **“peshës së automjetit”** të dorëzuara nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40.2, 40.6 dhe 40.7 të RRPP 001/2022 dhe si rrjedhojë vlerëson se **pretendimi është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me eliminimin e OE ankues për shkak të çmimeve jo normalisht të ultë pa zhvilluar një procedurë interparts për sqarimin e çmimeve eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja me njoftimin për vendim njëra ndër arsytet e eliminimit ka qene edhe për shkak të çmimeve jo normalisht të ultë.

Sipas RRPP 001/2022 Neni 41.3

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i.	çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
ii.	çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë	

Eksperti shqyrtues vlerëson se gjate aktivitetit te prokurimit nuk janë plotësuar te gjitha kushtet sikurse kërkohet me nenin 41.3 dhe se trajtimi i ofertës se OE ankues si oferte jo normalisht e ulte është ne kundërshtim me RRPP 001/2022 dhe rrjedhimisht **pretendimi është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.4

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues qe ka te bëjë me Nenin 11 te LPP-se mbi klasifikimin e informatave sekrete afariste dhe deklarates se OE ankues se nuk i është dhënë qasje ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate me arsyetimin se e ka plotësuar Kërkesën për konfidencialitet dhe se përkundër faktit se edhe OE ankues e ka te plotësuar kërkesën për konfidencialitet OE i rekomanduar për kontratë në fazën e rishqyrtimit te parë i është dhënë qasje e plotë ne ofertën e OE tani ankues eksperti shqyrtues sqaron se Neni 11 te LPP-se dhe Neni 7 paragrafi 7.5 dhe 7.6 i RRPP 001/2022 e rregullon çështjen qe ka te bëjë me klasifikimin e informatave sekrete afariste.

OE ankues përkundër faktit se e ka plotësuar kërkesën për sekret afarist sipas nenit 68 dhe 69 AK-ja me arsyetimin se janë konsultuar me KRPP dhe se i ka udhëzuar qe tu jap qasje të plote. Eksperti shqyrtues ka kërkuar sqarime nga AK-ja në lidhje me shkresën e KRPP me përgjigjen qe ti jepet qasja por qe nuk i është ofruar një e tillë me arsyetimin se konsultimi është bërë përmes telefonit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka qenë e obliguar që në përputhje me Nenin 11 paragrafi 4 i LPP-së është dashur ti ofrojë një version të pastruar te çdo dokumenti por që ka dështuar ta bëjë kështu që duke i vështirësuar OE ankues te artikulojë pretendimet e tij për ankimim te vendimit te AK-se. E njëjta është e sqaruar edhe përmes Interpretimit te KRPP me nr 31 te datës 24.10.2023 ku ne fund citoj “Sipas nenit 7.7 të RRPP, Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik. Për këtë qëllim, AK duhet të veprojë në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se **pretendimi ankimor është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr 5

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit është kërkuar:

OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt përveq stafit të diplomuar çertifikuar OE duhet të ketë min. 20 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve.

a) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip.i Komunikacionit - minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1(një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë nënshkruar nga vet ai dhe kompania

b) Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion. Të ketë së 1 referenca të udhëhequr të natyrës së njëjtë). Të caktohet me shkresë dhe të jetë nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania

Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për ti plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referencë nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitat e kërkuara. Për stafin teknik - kontratat e punës ose parakontrata valide në kohëzgjatje të kontratës

OE ankues me ofertë ka dorëzuar listën e stafit profesional ku për kërkesën a) ka dorëzuar inxhinierin B.S i cili sipas CV ka deklaruar se nga viti 2018 -aktualisht është në kompaninë Bageri. I njëjti ka dorëzuar edhe referenca nga disa OE te ndryshëm ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit.

Për pozitën inxhinier i diplomuar i Bujqësisë OE ankues ka dorëzuar inxhinierin N.M i cili sipas CV ka deklaruar ka punuar ne kompaninë Agrounion nga 2007-2016. I njëjti ka dorëzuar dy referenca. Referenca e lëshuar nga OE ankues është për natyrën e njëjtë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Arsyeja e eliminimit te OE ankues për shkak se inxhinieri B.S nuk ka rezultuar ne listën e verifikimit ne ATK nuk qëndron sepse me dosje te tenderit është kërkuar qe "për ti plotësuar kërkesat duhet te ofrohen edhe dëshmitë se paku një letër reference nga punëdhënësi".

Sa i përket inxhinierit N.M është kërkuar qe te ketë reference te natyrës se njëjtë. Inxhinieri ka dorëzuar referencën e lëshuara nga OE ankues për te cilën sipas mendimit te ekspertit shqyrtues duhet te trajtohet sipas nenit 72 te LPP-se RRUOPP 001 /2023 nenit 10.1.

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
---	-------------------------------------	----

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi **në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “VIA EGNATIA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve” me numër të prokurimit: “615-23-4993-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **VIA EGNATIA SH.P.K.**



Burim Zeka